

V E N D I M
Nr.4, datë 8.4.1994

Gjykata Kushtetues e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani	Zv.kryetar	i ""
Manol Konomi,	Anëtar	i ""
Hilmi Dakli,	Anëtar	i ""
Franc Jakova,	Anëtar	i ""
Thimjo Kondi,	Anëtar	i ""
Natasha Sheshi,	Anëtare	e ""
Ylvi Myrtja,	Anëtar	i ""
Veli Budo,	Anëtar	i ""

me sekretare Drita Filto, më datën 1.9.1993, 10.9.1993, 26.10.1993, 22.11.1993, 14.1.1994, 25.1.1994, 25.2.1994, 11.3.1994, 8.4.1994 shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.12/1 Akti, që u përket:

KËRKUESVE: 1. SHOQATA E PRIVATËVE TË LIRË SHQIPTARË, e përfaqësuar nga avokati Spartak Ngjela.

2. SHOQATA KOMBËTARE E TË SHPRONËSUARVE “PRONËSI ME DREJTËSI”, e përfaqësuar nga avokati Sadedin Xhafa. Në seancën e datës 11.3.1994 në mungesë.

3. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALDEMOKRATE TË SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga kryetari Teodor Laço.

O B J E K T I

Deklarimi i pakushtetueshmërisë dhe shfuqizimi i neneve 12 dhe 17 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës,

V Ë R E N :

Shoqata e “Privatëve të Lirë Shqiptarë”, me kërkesën datë 21.4.1993, ka kërkuar shpalljen si antikushtetues të neneve 12 dhe 17 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, për këto shkaqe kryesore:

1. Neni 12 i këtij ligji, duke u kthyer ish-pronarëve trojet e zëna me ndërtesa nga persona të tjerë fizikë apo juridikë, që i kanë blerë nga shteti pas datës 1 janar 1991, në fakt prish kontratat e shitjes. Një kompetencë e tillë nuk i përket ligjvënësit, por organeve gjyqësore. Si rrjedhojë, me këtë dispozitë pushteti ligjvënës ka shkelur nenin 3 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” në të cilin sanksionohet parimi i ndarjes së pushteteve në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si parim themelor i organizimit tonë shtetëror.

2. Me nenin 17 të ligjit në fjalë, në mënyrë arbitrare e pakurfarë qëllimi publik është pranuar bashkëpronësia në pjesë mbi lokalet tona private, që organet kompetente shtetërore na i kanë shitur me kontrata të ligjshme të lidhura pa asnjë lloj barre.

3. Parashikimet e neneve 12 dhe 17 përbëjnë në thelb një shpronësim të pronarëve të lirë, që nuk ka qëllime publike dhe, për rrjedhojë, vinë në kundërshtim me nenin 27 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.

Para përfundimit të shqyrtimit të kërkesës së mësipërme, Gjykatës Kushtetuese i janë drejtuar edhe dy subjekte të tjerë, Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi” dhe Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate.

Shoqata “Pronësi me Drejtësi” me kërkesën datë 24.11.1993, ka kërkuar deklarinimin si antikushtetues dhe shfuqizimin e ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën”, të ligjit nr.7699, datë 23.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokave bujqësore” si dhe të neneve

5,13,14,17, 19, 23, 25 e 26 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Shoqata e mësipërme, me kërkesën datë 2.2.1994, atakon në këtë Gjykatë edhe nenin 12 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” si dhe ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, së bashku me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.347, datë 10.8.1992. Shoqata “Pronësi me Drejtësi” pretendon, ndër të tjera, se nenet 12 dhe 17 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” duhet të deklarohen antikushtetues e të shfuqizohen, sepse cenojnë të drejtën e ish-pronarëve për të përfutur rikthimin e plotë të ish-pronave të tyre.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, me kërkesën datë 21.2.1994 kërkon deklarimin si antikushtetues dhe shfuqizimin e neve 12 dhe 17 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, për këto shkaqe kryesore:

1. Duke pranuar konceptin e bashkëpronësisë së detyruar midis pronarit të lokalit dhe ish-pronarit të truallit, në fakt bëhet një shpronësim arbitrar i pronarit të lokalit për një pjesë të pronës së tij të ligjshme, në kundërshtim me nenin 27 të ligjit kushtetues “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

2. Nëpërmjet nenit 12, me akt të pushtetit ligjvënës prishen kontratat e shitjes duke u shkelur prej tij një e drejtë ekskluzive e pushtetit gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese, duke u nisur nga fakti se kërkesa e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate është e njëjtë në thelb me kërkesën e Shoqatës së “Privatëve të Lirë Shqiptarë” dhe se kërkesa e Shoqatës “Pronësi me Drejtësi” pjesërisht ka lidhje me kërkesat e mësipërme vetëm përsa u përket neneve 12 dhe 17 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, me vendimin e ndërmjetshëm të datës 25.2.1994 vendosi të bashkojë në gjykimin e filluar, të inicuar nga “Shoqata e Privatëve të Lirë Shqiptarë”, edhe kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate si dhe pjesën e kërkesës së Shoqatës “Pronësi me Drejtësi” që ka të bëjë me atakimin për pakushtetueshmëri, nga këndvështrimi i ish-pronarëve, të neneve 12 dhe 17 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Në të njëjtën kohë u vendos që pjesët e tjera të kërkesës së Shoqatës “Pronësi me Drejtësi” të shqyrtohen si çështje më vete.

Në lidhje me pretendimet e parashtruara në kërkesat e mësipërme të bashkuara proceduralisht në një gjykim të vetëm, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë konkludon si më poshtë:

Me ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” u shfuqizimin Kushtetuta e vitit 1976, me të cilën shteti diktatorial i PPSH-së kishte shpallur edhe “de jure” monopolin e vet tërësor në çdo degë e nëndegë të ekonomisë. Njëkohësisht u sanksionuan, ndër të tjera, parimet themelore për krijimin dhe zhvillimin e ekonomisë së tregut edhe në Republikën e Shqipërisë, siç janë sidomos a) shumëllojshmëria e pronave, iniciativa e lirë e secilit subjekt ekonomik dhe roli rregullues i shtetit në fushat më kryesore të zhvillimit ekonomik; b) se subjekte të së drejtës së pronësisë janë shteti, personat juridikë e fizikë, dhe se të gjitha llojet e pronësisë gëzojnë mbrojtje ligjore të barabartë (nenet 10 e 11).

Vlerat dhe parimet e lartpërmendura të këtij ligji kushtetues duheshin shtjelluar domosdoshmërisht më tej me ligje të posaçme. Prandaj, u miratua para së gjithash ligji nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”. (Ndryshuar me ligjin nr.7653, datë 23.12.1992). Mbi këtë bazë të re kushtetuese e ligjore, dhe të akteve të tjera të ligjshme të pushtetit ekzekutiv, filloi procesi i “vetëshpronësimit” të shtetit në favor të pronësimit të individëve.

Në këto dy ligje u përcaktuan kriteret për privatizimin e pronës shtetërore dhe për kalimin e ekonomisë së vendit tonë nga një ekonomi e centralizuar në duart e shtetit në një ekonomi të tregut. Në nenin 3 paragrafi 1, të këtij ligji janë caktuar sektorët e ekonomisë që janë të lirë të privatizohen, duke përfshirë në to edhe njësitë e tregtisë, të artizanatit, të shërbimeve jetësore, etj.

Nga sa më lart nxirret përfundimi se me hyrjen në fuqi të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” shteti nuk u shpronësua menjëherë nga pasuritë të cilat në atë kohë figuronin “de jure” në pronësi të tij. Përkundrazi ai vazhdon të veprojë me cilësinë e tij si pronar dhe, si i tillë, ai përcakton vetë pronat shtetërore që mund të privatizohen, organet e ngarkuara për të bërë privatizimin si dhe mënyrat e realizimit të tij.

Për kalimin e pronës shtetërore në pronë private u krijua pranë Këshillit të Ministrave, Agjencia Kombëtare e Privatizimit, e cila është kompetente për drejtimin, organizimin dhe

bashkërendimin e punës për procesin e privatizimit (neni 22). Sipas dispozitës së sipërpërmendur, “Ajo jep autorizimin, shpall formën, cakton kohën dhe radhën e kalimit të objekteve të pronës shtetërore në pronë private”.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 21 paragrafi i fundit, të po këtij ligji u çel rruga që personave fizikë a juridikë privatë t’u kalohet në pronësi kundrejt pagesës truall për ndërtim. Nëpërmjet kësaj dispozite ligjore u përcaktua shprehimisht se “personat juridikë a fizikë vendas pronarë të ndërtesave ekzistuese të çdo lloji janë edhe pronarë të truallit që zenë këto ndërtesa...”.

Sa u përmond më lart përbën bazën kushtetuese e ligjore për krijimin e pronësisë të pronarëve blerës të trojeve e të lokaleve. E drejta e tyre subjektive e pronësisë është e prejardhur nga e drejta e pronësisë shtetërore dhe jo nga e drejta e pronësisë së ish-pronarëve të mëparshëm. Si rrjedhim nuk ekziston e nuk ka bazë për krijimin e ndonjë marrëdhënie juridike për shkak të pronësisë (gëzimit, posedimit e disponimit) të trojeve të blera e objekteve të ngritura mbi to, si dhe të detyrimeve përkatëse midis ish-pronarëve dhe pronarëve të rinj.

Krahas procesit të privatizimit të pronës shtetërore, shteti i ri demokratik u vu përballë një realiteti me probleme të mprehta politike, ekonomike e sociale, rrjedhojë e padrejtësive të bëra nga shteti totalitar komunist për rreth 50 vjet rrjesht ndaj pronarëve privatë. Këta të fundit janë zhveshur nga pronat e tyre të ligjshme me veprime krejt arbitrare e pa asnjë bazë ligjore, dhe nëpërmjet shtetëzimeve, shpronësimeve, konfiskimeve e masave të tjera, të bazuara në ligje, akte nënligjore e në vendime gjyqësore, që binin në kundërshtim me frymën e drejtësisë e të dinjitetit njerëzor, me të drejtat universale të patjetërsueshme e të gjithëpranuara në botën demokratike perëndimore.

Nëpërmjet ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, shteti i ri demokratik, ndonëse nuk ishte përgjegjës për padrejtësitë e së kaluarës, mori përsipër detyrimin moral e ligjor për të vënë në vend, sa të jetë e mundur më mirë, disa nga padrejtësitë e regjimit të mëparshëm që i përkasin periudhës pas datës 29 nëntor 1944.

Duke iu referuar formulimit të nenit 1 të këtij ligji e një sërë dispozitash të tjera, Gjykata Kushtetuese konkludon se ligji në fjalë përshkohet nga parimi sipas të cilit shteti merr përsipër (detyron vetveten) t’u kthejë ish-pronarëve, domethënë, t’i ripronësojë ata me ato prona që faktikisht dhe juridikisht është e mundur të kthehen, mbasi ekzistojnë efektivisht e janë në fondin e pronësisë shtetërore, ose mbahen pa arsye të përligjura nga të tjerët. Për trojet që janë zënë me ndërtime shtetërore të përhershme, apo që janë tjetërsuar në subjekte të tjerë, të cilët aktualisht i gëzojnë, posedojnë e disponojnë ato mbi një bazë të ligjshme e me mirëbesim, riparimi do të bëhet vetëm nëpërmjet kompensimit në natyrë apo në para e në letra me vlerë (neni 16 i ligjit). Nëpërmjet kësaj zgjidhjeje jo vetëm që synohet të vihen në vend të drejtat e cenuara e të shkeluara të ish-pronarëve, por, në të njëjtën kohë u pritet rruga padrejtësive të tjera eventuale ndaj personave që nuk kanë pse të mbajnë përgjegjësi e të detyrohen për arbitraritetet e një regjimi të përmbysur.

Zgjidhja parimore e përmendur më lart gjen shprehjen e saj adekuate sidomos në nenet 2,4,6,15,16 etj. të ligjit në fjalë.

Përsa u përket neneve 12 dhe 17 të këtij ligji, shqyrtimi i kushtetutshmërisë së të cilëve përbën objektin e këtij gjykimi, Gjykata Kushtetuese konkludon se disponimet e tyre vinë në kundërshtim me disa parime e norma kushtetuese të miratuara me ligjet kushtetuese në fuqi e gjithëpranuara në aktet juridike ndërkombëtare, të cilat sigurojnë mbrojtjen e pronësisë private nga veprimet e padrejta e arbitrare të shtetit apo të subjekteve të tjerë.

Sipas nenit 27 të Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993 vetëm ose “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, “Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta të ketë pronë private vetëm ose së bashku me të tjerë, si dhe e drejta për të trashëguar. Fitimi, gëzimi dhe tjetërsimi i pronës, si dhe e drejta e trashëgimisë rregullohen me ligj.

Askush nuk mund të shpronësohet, përveçse për një interes publik dhe kundrejt shpërblimit të plotë”.

Një nga mënyrat e ligjshme të fitimit të pronësisë është edhe kontrata e shitjes si veprim juridik i dyanshëm. Ajo është e vlefshme edhe për kalimin e pronësisë së sendeve nga shteti tek individ, duke shërbyer kështu si mjet juridik për fitimin e pronësisë private në mënyrë të prejardhur nga e drejta e pronësisë shtetërore.

Pronësia e trojeve dhe e ndërtesave (lokaleve) të përmendura në nenet 12 dhe 17 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” është fituar sidomos nëpërmjet kontratave të lidhura me agjencitë përkatëse të privatizimit ose, në disa raste, nëpërmjet ndërtimit të lokalit mbi

truallin e dhënë në mënyrë të rregullt nga shteti. Ligjvënësi, duke disponuar se “Trojet e zëna nga persona të tjerë fizikë ose juridikë, të cilët i kanë blerë nga shteti pas datës 1 janar 1991 për ndërtimin e banesave individuale dhe lokaleve të tregtisë e shërbimeve, i kthehen në pronësi ish-pronarit, ndërsa shteti i kthen personit fizik ose juridik që e ka blerë, shumën e derdhur për truallin” (neni 12, paragrafi 1) dhe se “Në trojet, në të cilat janë ndërtuar lokale, ish-pronarit të truallit i njihet pronësia mbi truallin”, (neni 17, paragrafi 1) në fakt ndërhyjnë në kontratat e shitjes të lidhura rregullisht, në bazë të ligjit të kohës, dhe, në mënyrë të njëanshme, urdhëron prishjen tërësore apo të pjesshme të këtyre kontratave. Kjo përbën një cenim të hapur të së drejtës së pronësisë private, të njohur e të garantuar si e drejtë themelore e njeriut. (neni 27 i ligjit “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”).

Kontratat në të cilat shteti ka marrë pjesë si palë shitëse e këtyre lokaleve, edhe sikur të vërtetohen shkaqe të përligjura që i bëjnë ato të pavlefshme, nuk mund të zgjidhen në mënyrë të njëanshme po nga shteti nëpërmjet organeve të tij ligjvënëse apo ekzekutive, sepse shkelet parimi i njohur juridik i gjithëpranuar, sipas të cilit askush, qoftë ky edhe shteti, nuk mund të bëhet gjyqtar i çështjes së vet. (Nemo iudex in causa sua).

Siç pretendojnë me të drejtë Shoqata e “Privatëve të Lirë Shqiptarë” dhe Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, kompetenca për prishjen e kontratave, jo nëpërmjet një urdhërimi të përgjithshëm, por nëpërmjet gjykimit të çdo rasti konkret, kur vërtetohen shkaqet e parashikuara në ligjin ku është bazuar kontrata, i përket vetëm gjykatës kompetente. Në të kundërt, shkelet një e drejtë ekskluzive e pushtetit gjyqësor, që është i ndarë dhe më vete nga dy pushtetet e tjera, ai ligjvënës dhe ekzekutiv.

Sipas paragrafit të dytë të nenit 17, ish-pronarit të truallit i njihet në mënyrë të detyrueshme e drejta e bashkëpronësisë në pjesë në truallin e në ndërtesën e ngritur mbi të, së bashku me pronarin e ligjshëm të tyre, ndërsa në paragrafet e tjera parashikohen kriteret e përcaktimit të madhësisë së pjesëve, kushtet e bashkëpronësisë e kufizimet e saj, të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve, koha dhe mënyrat e mbarimit të marrëdhënies së bashkëpronësisë etj.

Krijimi në mënyrë të detyruar i marrëdhënieve juridike të mësipërme, në veçanti i një lloji bashkëpronësie të panjohur deri më sot në pikëpamje teorike dhe në praktikë bie ndesh me normën kushtetuese të lartpërmendur që njeh, mbron dhe garanton të drejtën themelore të pronësisë private, sepse bashkëpronësia në pjesë apo në tërësi në çdo rast krijohet mbi bazën e vullnetit të lirë e të marrëveshjes midis pronarëve të veçantë e jo në mënyrë të detyrueshme me imponim shtetëror e me forcën e ligjit. Ajo mund të krijohet edhe nëpërmjet një fakti juridik që sjell një suksesim universal, siç është për shembull, trashëgimia, por në çdo rast ajo nuk mund të qëndrojë pa vullnetin e bashkëpronarëve. Pushteti ligjvënës apo ai ekzekutiv nuk mund të kalojnë në pronësi apo në bashkëpronësi të të tjerëve, në rastin konkret të ish-pronarëve, pasuri që nuk i përket në pronësi vetë shtetit, por subjekteve të tjerë privatë. (Përveç rasteve të shpronësimeve për interesa publike e në kushtet e lartpërmendura).

Siç me të drejtë pretendohet nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate dhe shoqata e “Privatëve të Lirë” urdhërimet e neneve 12/1 dhe të nenit 17, për kalimin e pronësisë së trojeve e të lokaleve të blera apo të ndërtuara në pajtim me ligjin, në pronësi apo në bashkëpronësi të personave të tjerë, në mënyrë të detyrueshme, përbën në thelb një shpronësim arbitrar të pronarit të tyre, i cili bie ndesh me paragrafin e dytë të nenit 27 të ligjit kushtetues “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.

Gjykata Kushtetuese çmon se nenet 12/1 dhe 17 të ligjit në fjalë, përveç se janë antikushtetutes, bien në kundërshtim edhe me rregullime të tjera të plota e të arsyeshme të pranuar në këtë ligj e në ligje të tjera dhe se shfuqizimi i tyre (neni 12/1 e 17) nuk krijon boshllëk legjislativ. Për rrjedhojë ajo nuk e çmon të nevojshme t’i kërkojë Parlamentit dhe Qeverisë marrjen e masave për një rregullim të ri të marrëdhënieve përkatëse.

Përsa i përket paragrafit të dytë të nenit 12, që parashikon lidhjen e marrëdhënieve kontraktore midis pronarëve të veçantë dhe zgjidhjen gjyqësore të mosmarrëveshjeve eventuale. Gjykata Kushtetuese çmon se në parim ai nuk është antikushtetues, prandaj, me ndonjë modifikim e saktësim të nevojshëm që është prerogative e pushtetit ligjvënës, ai mund të qëndrojë në fuqi.

Sidoqoftë, sfera e zbatimit të kësaj norme në pajtim me parimet kushtetuese, ngushtohet shumë me të drejtë prej paragrafit të tretë të nenit 12, si dhe prej neneve 4, 6 e 16 të ligjit në fjalë, sipas të cilave ish-pronarët nuk përfitojnë kthimin e trojeve, por vetëm kompensimin përkatës apo diferencën e kompensimit të papërfutur.

Gjykata Kushtetuese, në të njëjtën kohë çmon se shfuqizimi i lgjislacionit të miratuar nga regjimi komunist për rreth 50 vjet, nuk mund të çojë në rivendosjen e marrëdhënieve të pronësisë siç kanë qenë në vitin 1944, as në shpërblimin e plotë të dëmeve të pësuar, për arsye të ndryshimeve objektive në kohë e për shkaqe të justifikuara juridike.

Edhe pretendimi tjetër, sipas të cilit ligji për privatizimin është antikushtetues, sepse shkel të drejtën e parablerjes të ish-pronarëve për pronat e shpronësuara padrejtësisht, nuk qëndron. Kjo jo vetëm për arsye se ky ligj nuk është objekt i këtij gjykimi, por edhe për arsye se e drejta e parablerjes si nocion juridik ekziston vetëm për bashkëpronarin në bashkëpronësinë në pjesë apo në tërësi dhe jo për subjekte të tjerë apo jashtë marrëdhënieve të bashkëpronësisë. Në marrëdhëniet juridike që lindin gjatë privatizimit të pronës shtetërore, pronar i kësaj prone vazhdon të jetë shteti dhe ky vetë bën disponimin e saj. Problemet që lindin për mënyrat e disponimit, grupet sociale që duhet të përfitojnë etj., janë probleme që kërkojnë zgjidhje politike të caktuara dhe, si të tilla, u përkasin forcave politike të përfqësuar në Kuvend dhe vetë Kuvendit si organ më i lartë i pushtetit ligjvënës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 2 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992, me shumicë votash,

VENDOSI:

Të deklarojë papajtueshmërinë me dispozitat kushtetuese të neneve 12 paragrafi i parë dhe 17 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” dhe t’i shfuqizojë ato.

Vendimi është i formës së prerë dhe hyn në fuqi të nesërmen e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Votuan pro këtij vendimi Feti Gjilani, Thimjo Kondi, Veli Budo, Natasha Sheshi e Ylvi Myrtja.

Votuan kundër Rustem Gjata, Manol Konomi, Franc Jakova e Hilmi Dakli, me këtë arsyetim:

MENDIMI I PAKICËS

Në kundërshtim me vendimin e dhënë me shumicë votash, pakica është për rrëzimin si të kërkesave të shoqatës së “Pronarëve të Lirë” dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, ashtu edhe të kërkesës së shoqatës të ish-pronarëve “Pronësi me Drejtësi” për nenet 12 e 17 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, për arsyet e mëposhtme:

Përpara Gjykatës Kushtetuese, pas bashkimit vetëm pjesërisht për koneksitet (për nenet 12 e 17) të kërkesave të palëve ndërgjyqëse, shtrohej medoemos detyra e shqyrtimit për papajtueshmëri me dispozitat kushtetuese e dispozitave ligjore të mësipërme nën prizmin e pretendimeve si të njëres palë ashtu edhe të tjetres.

Çështja në gjykim-shpallja e neneve 12 e 17 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 si të papajtueshëm me dispozitat kushtetuese dhe shfuqizimi i tyre i vlerësuar me kompleksitetin e saj, ka rëndësi juridike dhe një karakter thellësisht social dhe ekonomik.

Dy kategori pronarësh vihen ballë për ballë njëra tjetrës: pronarët e vjetër ose origjinalë dhe pronarët e rinj, blerës të lokaleve të shitura nga shteti nga viti 1991. Si njëra ashtu edhe tjetra palë pretendojnë, duke parashtruar arsyet, se nenet 12 e 17 të ligjit të lartpërmendur, përbëjnë një shkelje të së drejtës së tyre mbi pronën, e drejtë kjo e garantuar me dispozitat kushtetuese.

Subjektivisht të dy këto kategori pronarësh ndodhen në kushte të njëjta, për arsye se secila prej tyre kërkon shpalljen si antikushtetuese të të njëjtave dispozita ligjore (të neneve 12 e 17), por objektivisht, ato janë në situatë të diferencuara, për arsye se kërkojnë shfuqizimin e këtyre dispozitave për shkaqe të ndryshme e rrjedhimisht me pasoja të ndryshme, diametralisht të kundërta.

Shoqata “Pronarët e lirë” pretendon se pronarët e sotëm, heqin të drejtat e tyre nga ligji nr.7512, datë 10.8.1991, në bazë të të cilit shteti pronar në atë kohë i lokaleve, ka lejuar dhe u ka shitur atyre këto lokale, ndërsa ish-pronarët, të grumbulluar në shoqatën “Pronësi për drejtësi”, pretendojnë se të drejtat e tyre gjejnë mbështetje të plotë në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 që u njeh atyre të drejtën

e pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara etj, që nga viti 1944.

Pakica është e mendimit se ligjvënësi me të drejtë nuk ka lejuar një diskriminim në favor ose në dëm të njëres ose tjetres palë. Përkundrazi, ligjvënësi është përpjekur të vërë të dy këto kategori pronarësh në një shesh barazie, të harmonizojë të drejtat e tyre dhe brenda mundësive t'i pajtojë ato, duke pasur parasysh edhe interesin e përgjithshëm.

Pajtimi është arritur me ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 dhe në mënyrë të veçantë me nenin e parë të këtij ligji, ku ndër të tjera thuhet shprehimisht se ky ligj "përcakton mënyrat dhe masat për kthimin dhe kompensimin e pronave". Me këtë nen nga njëra anë, u njihet ish-pronarëve e drejta e pronësisë mbi pronat e tyre që nga viti 1944, por nga ana tjetër ai i vë kësaj të drejte dhe disa kufizime që përmbajnë sidomos nenet 12 e 17 të cilat një kohë janë kufizuar edhe për pronarët e rinj.

Shpallja e neneve 12 e 17 si të papajtueshme me dispozitat kushtetuese sjell patjetër shfuqizimin edhe të pjesës së fundit të nenit 1 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993: "Ligji përcakton mënyrat dhe masat për kthimin dhe kompensimin" duke u njohur ish-pronarëve e drejta që nga viti 1944, pa asnjë kufizim, pavarësisht se kjo e drejtë është juridikisht ose faktikisht e realizueshme ose jo.

Paragrafi i parë i nenit 12 që u shfuqizua me vendimin e shumicës kishte këtë përmbajtje: "trojet e zëna nga persona të tjerë fizikë ose juridikë, të cilët i kanë blerë nga shteti pas datës 1 janar 1991 për ndërtimin e banesave individuale dhe lokaleve të tregtisë dhe shërbimeve, i kthehen në pronësi ish-pronarit, ndërsa shteti i kthen personit fizik ose juridik që e ka blerë shumën e derdhur për truallin. Shfuqizimi i tij u bë me arsyetimin se "Pronarët e rinj këto troje i kanë blerë me kontrata të shitjes të lidhura rregullisht në bazë të ligjit të kohës".

Shumica e njeh parimin universal të pranuar në të gjitha kohërat dhe nga të gjitha shtetet se "pasuria e grabitur i kthehet të zotit, pavarësisht nëse grabitësi e ka në zotërim të vet apo ia ka tjetërsuar personave të tjerë". E megjithatë shumica i jep vlerë të plotë kontratës së shitjes, ndonëse të dyja palët që e kanë lidhur kontratën e dinin se objekti i shitur ishte i grabitur nga shteti totalitar komunist. Por, pavarësisht nga kjo, shumica ka injoruar faktin se me ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", është shfuqizuar Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e 28 dhjetorir 1976, me të cilën e gjitha toka ishte shpallur pronë vetëm e shtetit. Rrjedhimisht shteti, pas kësaj date (29.4.1991) nuk ka pasur të drejtë të shesë trojet e ish-pronarëve, sepse juridikisht nuk ishte më pronar i tyre.

Nga sa u tha më sipër del përfundimi se konkluzioni i shumicës "E drejta e tyre subjektive e pronësisë është e prejardhur nga e drejta e pronësisë shtetërore dhe jo nga e drejta e pronësisë së ish-pronarëve të mëparshëm", nuk ka asnjë bazë kushtetuese përse i përket trojeve. Shteti, gjatë periudhës nga hyrja në fuqi e ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", e deri në miratimin e ligjit "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve" u shndërrua juridikisht në një administrator të përkohshëm, deri sa t'ua kthente pronat ish-pronarëve të ligjshëm.

Në arsyetimin e shumicës thuhet se "Kompetencat për prishjen e kontratave jo nëpërmjet një urdhërimi të përgjithshëm, por nëpërmjet gjykitimit të çdo rasti konkret, kur vërtetohen shkaqet e parashikuara në ligjin ku është bazuar kontrata, i përket vetëm gjykatës kompetente, në të kundërt shelet një e drejtë ekskluzive e pushtetit gjyqësor..."

Por edhe me nenet 10 e 11 të këtij ligji janë shfuqizuar kontratat për blerjen e ndërtesave dhe të trojeve të pazëna të ish-pronarëve nga persona të të tretë, në të njëjtën mënyrë, siç është vendosur edhe në paragrafin e parë të nenit 12.

Shumica nuk shprehet fare për nenet 10 e 11, duke lejuar që në të njëjtin ligj të qëndrojnë, pas shfuqizimit të paragrafit të parë të nenit 12, dy kritere krejt të ndryshëm për shfuqizimin e kontratave për raste të së njëjtës natyrë. Për vetë kontekstin që kanë në përmbajtje nenet 10 e 11 me paragrafin e parë të nenit 12, shumica duhej t'i përfshinte dhe analizonte bashkërisht.

Për këtë çështje, mendojmë se shfuqizimi me ligj i kontratave të bazuara në ligje e akte të tjera antikushtetuese, është plotësisht i drejtë dhe nuk përbën aspak ndëhyrje në kompetencat e pushtetit gjyqësor.

Për paragrafin e dytë të nenit 12 të ligjit, shumica është shprehur se nuk është antikushtetues. Në këtë paragraf thuhet: "Personat fizikë ose juridikë privatë, të cilët kanë në pronësi ndërtesën detyrohen t'i paguajnë pronarit të truallit qira ose të riblejnë truallin sipas kontratës së lidhur ndërmjet palëve". Atëherë lind pyetja: si do t'i paguajë pronari i ndërtesës qira pronarit të truallit, kur këtij të fundit nuk i kthet pronësia mbi truallin pas shfuqizimit të paragrafit të parë të nenit 12? Këto dy

paragrafë ishin në lidhje dhe në varësi ndërmjet tyre: i pari i kthente pronësinë mbi truallin ish-pronarëve, ndërsa i dyti detyronte pronarët e ndërtesave t'i paguanin qira pronarëve të trojeve. Kështu, pas shfuqizimit të paragrafit të parë të nenit 12, paragrafi i dytë i po atij neni mbetet i pazbatueshëm.

Neni 17 i ligjit objekt gjykimi rregullonte marrëdhëniet e pronësisë në rastet kur mbi trojet e ish-pronarëve shteti i mëparshëm kishte ndërtuar lokale tregtie e shërbimi, të cilat më vonë (gjatë viteve 1991-1993) shteti ua kishte shitur personave të tretë-pronarëve të rinj.

Shumica e shfuqizon këtë nen duke mos u njohur të drejtën ish-pronarëve që t'u kthehet pronësia mbi truallin, me po atë arsytim që ka bërë për paragrafin e parë të nenit 12 siç u analizua më sipër. Nocionin e bashkëpronësisë së pronarit të truallit (ish-pronarit) dhe pronarit të lokalit (pronari i ri) mbi truallin dhe lokalit, shumica e quan "shpronësim arbitrar të pronarit të tyre" (d.m.th, të pronarit të ri).

Vërejmë këto se bashkëpronësia ndërmjet pronarit të truallit dhe pronarit të lokalit mbi truallin dhe lokalit nuk është imponim i ligjvënës, por konstatim dhe zgjidhje adekuate e gjendjes së krijuar, ku trualli dhe lokali mbi të janë lidhur në mënyrë të pazgjidhshme. Si pronarit të truallit ashtu edhe pronarit të lokalit u janë njohur pjesët sipas kontributit të tyre në vleftë, pra nuk mund të flitet për shpronësim të asnjërës palë.

Në vendimin e saj shumica shprehet për "padrejtësitë e bëra nga shteti totalitar komunist për 50 vjet rresht ndaj pronarëve privatë. Këta të fundit janë zhveshur nga pronat e tyre të ligjshme e veprime krejt arbitrare e pa asnjë bazë ligjore dhe nëpërmjet shtetëzimeve, shpronësimeve, konfiskimeve e masave të tjera, të bazuara në ligje, akte nënligjore e me vendime gjyqësore që binin në kundërshtim me frymën e drejtësisë e të dinjitetit njerëzor, me të drejta universale të patjetërsueshme e të gjithëpranuara në botën demokratike perendimore".

Realisht me shfuqizimin e paragrafit të parë të nenit 12 dhe të krejt nenit 17, shumica mban qëndrim flagrant në kundërshtim nga ajo që thotë më sipër. Pra,. Edhe deklaroi se ish-pronarët janë privuar padrejtësisht nga pronat e tyre për 50 vjet, edhe ua mohoi atyre përfundimisht me vendim mundësinë e kthimit të trojeve, që ligji ua njeh me fuqi prapavepruese.

Për të gjitha këto arsye, pakica është e mendimit se Gjykata Kushtetuese nuk duhej të prishte ekuilibrin e vendosur nga ligjvënësi në mes interesave të dy kategori pronarëve, të vjetër dhe të rinj. Rrjedhimisht pakica është e mendimit se duhej të vendosej nga kjo Gjykatë rrëzimi i kërkesës së shoqatës "Pronarët e Lirë", ashtu edhe të shoqatës "Pronësi me Drejtësi" për shpalljen e neneve 12 e 17 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 si të papajtueshëm me Kushtetutën.

Të njëjtin qëndrim gjykata duhej ta mbante ndaj kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate edhe për këto arsye:

a) Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate ka votuar në favor të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993;

b) Ky grup i drejtohet Gjykatës Kushtetuese afër një vit pas miratimit të ligjit dhe në një kohë kur çështja shqyrtohej me kërkesën e palëve të lartpërmendura.

Pakica ka mendimin se asnjë grup parlamentar, nuk ka të drejtë juridikisht (kuptohet as moralisht) të kërkojë shpalljen e një ligji, në tërësi ose pjesërisht si të papajtueshme me dispozita kushtetuese, kur ai ka votuar për miratimin e ligjit. Vetëm grupet parlamentare që kanë votuar kundër miratimit të ligjit e kanë këtë të drejtë, të cilën duhet ta ushtrojnë brenda një kohe sa më të shkurtër dhe kudoherë para se ligji të jetë vënë në zbatim dhe të ketë prodhuar efektet e tij.

Në vendimin e saj shumica duhej të mbante qëndrim ndaj pretendimeve të shoqatës "Pronësi me drejtësi" në radhë të parë lidhur me efektin prapaveprues të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 (neni 1), si dhe lidhur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.347, datë 10.8.1992 që u njeh të drejtën e përparësisë punonjësve në blerje të objekteve që i kanë pasur në përdorim. Këto dy pretendime të ish-pronarëve nuk duhej t'i kalonte shkarazi, por t'u rezervonte hapësirën që u ka rezervuar pretendimeve të pronarëve të lirë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate. Ky qëndrim i shumicës u reflektua edhe në dispozitivin e vendimit të saj, ku nuk bëhet fjalë për "fatin" e kërkesës së ish-pronarëve.

Në vendimin e saj shumica jo vetëm nuk u pranon drejtpërdrejt mbi efektin prapaveprues të ligjit të lartpërmendur (neni 1), por në të kundërtën shfaq mendimin se "shfuqizimi i legjislacionit të miratuar nga regjimi komunist për rreth 50 vjet, nuk mund të çojë në rivendosjen e marrëdhënieve të pronësisë siç ka qenë në vitin 1944, as me shpërblim të plotë të dëmeve të pësura për shkak të ndryshimeve objektive në kohë e për shkaqe të justifikuara juridikisht". Me këtë vendim shumica ka

kapërcyer kompetencat e veta, duke ndërhyrë në një sferë që i përket Kuvendit dhe ekskluzivisht Kuvendit. Rivendosja ose jo, e plotë e pjesshme e marrëdhënieve të pronësisë siç ka qenë në vitin 1944 i përket Kuvendit, organ i vetëm ligjvënës.

Mosrealizimi juridikisht e faktikisht i së drejtës së ish-pronarëve, ose vështirësitë që mund të hasen gjatë zabtimit, nuk janë argument dhe as arsye për të mos njohur efektin prapaveprues të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 (neni 1),. Këtu e ka burimin e vet edhe pikëpamja jo e drjtë e shumicës (duke iu referuar nenit 1) se ky ligj “përshkohet nga parimi sipas të cilit shteti merr përsipër t’i ripunësojë ish-pronarët me ato prona që faktikisht dhe juridikisht është e mundur t’u kthehen, mbasi ekzistojnë efektivisht e janë në fondin e pronësisë shtetërore ose mbahen pa arsye të përligjura nga të tjerët”. Nuk kuptohet nga e mori këtë përfundim shumica, ku e mbështet një afirmim të tillë, që nuk gjen asnjë bazë në normën e nenit 1 të ligjit në fjalë, pasi në të nuk janë vënë kushte.

Shumica, duke invokuar në favor të pretendimeve të pronarëve të lirë normat e gjithëpranuara ndërkombëtare dhe nenit 27 të ligjit kushtetues “Për të drejta dhe liritë themelore të njeriut”, nuk merr parasysh se këto norma kanë vlerë për mbrojtjen e pronës private në përgjithësi dhe jo vetëm të pronës së pronarëve të lirë në dëm të ish-pronarëve, të cilët, siç pranohet edhe në vendim, janë zhveshur nga pronat e tyre të ligjshme me veprime arbitrare.

Në lidhje me pretendimin e ish-pronarëve se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.347, datë 10.8.1992, që u njeh punonjësve të lokaleve të drjtën e përparësisë në blerje, është në kundërshtim me ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private dhe privatizimit”, shumica detyrohej të jepte një përgjigje të plotë, është ose jo i kundërligjshëm, pasi ky vendim ka qenë objekt gjykimi.

Shoqata “Pronësi me drejtësi” në shkresën datë 2.2.1994 thotë: “Nga tërësia e këtyre dispozitave del se ligji (7512/1991) nuk parashikon ndonjë të drejtë parablerje për blerjen e lokaleve të tregtisë, artizanatit etj., në favor të punonjësve që i kishin në përdorim në atë kohë. Kjo e drejtë parashikohet vetëm në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.347, datë 10.8.1992”.

Nuk kuptohet përse shumica në vendimin e saj e çvendos çështjen dhe jep shpjegime reth “nocionit juridik” të së drejtës së parablerjes, duke u shprehur se ajo ekziston vetëm “për bashkëpronarin në bashkëpronësinë në pjesë apo në tërësi dhe jo për subjekte të tjerë apo jashtë marrëdhënieve të bashkëpronësisë”.

Shumica shpreh gjithashtu pikëpamjen se “në marrëdhëniet juridike që lindin gjatë privatizimit të pronës shtetërore, pronar i kësaj prone vazhdon të jetë shteti dhe ky vetë bën disponimin e saj”.

Kalimi i pronës shtetërore në pronë private, mënyrat e kalimit me ankand ose me forma të tjera është vendosur me ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” si marrëdhënie që janë në kompetencë ekskluzive të organit legjislativ. Dhe në asnjë nen të këtij ligji nuk parashikohet e drejta e përparësisë në blerje për personat që i mbanin lokalet në atë kohë.

Shumica nuk merr parasysh edhe një vendim të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese (vendim i marrë njëzëri), i cili shpall të kundërligjshëm vendimin e Këshillit të Ministrave që parashikonte mundësinë e vërtetimit të faktit të plagosjes gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, me vendim të gjykatës së rrethit.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.347, datë 10.8.1992, ka ngjashmëri me vendimin e lartpërmendur përse i përket kapërcimit të përmbajtjes së ligjit. Ashtu si në vendimin e parë edhe në vendimin nr.347/1992, shkohet tej përmbajtjes së ligjit nr.7512/1991, me njohjen e së drejtës së përparësisë në blerje një kategorie të caktuar personash, që përse i përket pasojave juridike është e barabartë me të drejtën e parablerjes, pasi përjashton kategoritë e tjera, si p.sh. ish-pronarët.

Të gjitha këto shumica në vendimin e saj kalon në heshtje, ndonëse përbëjnë shkelje të parimit kushtetues të barazisë së shtetasve (neni 25 i ligjit kushtetues për të drejtat e njeriut).

Këto janë argumentet dhe mbështetja ligjore që kanë determinuar tek pakica për të qenë kundër shpalljes si antikushtetues të paragrafit të parë të nenit 12 dhe të nenit 17 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

